

MONITOR:

ZBATIM I REFORMAVE URGJENTE PRIORITARE

Periodha: 20.11-15.12.2015

Zbatimi i marrëveshjes politike

Dinamika në zbatimin e Marrëveshjes politike është cënuar me kalimin e afateve krahas këmbënguljes së përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare me arritjen e pëlqimit në "kohë sa më urgjente"¹. Mediat, si temë kryesore gjatë negociatave për zbatimin e Marrëveshjes, sërish shkaktuan zvarritje të procesit për shkak të mosmarrëveshjeve ndërpartiake, por edhe kërkesat për përfshirje të mediave dhe organizatave gazetareske.

Për anëtarët e pavarur të Komisionit shtetëror zgjedhor (KSHZ) pëlqim u arrit pas shumë shtyrje të afateve.

Sipas deklaratës së lehtësuesit Vanhoute, momentalisht në rendin ditor gjenden ligjet për mediat, për Agjensionin për mediat, RTVM dhe gjobat për mediat. Plotësisht, duhet të negociohet edhe për zyrën e Avokatit të popullit, për Komisionin për parandalim të korrupsionit dhe çështje të caktuara lidhur me Ligjin për shpifje².

Sundimi i së drejtës dhe gjyqësori

Gjyqësori

Prokurorja speciale publike e respekton parimin e transparencës, duke e njoftuar rregullisht publikun për fushëveprimin e saj në Facebook profilin personal dhe gjatë preskonferencave³. Prokurorja speciale publike, në bashkëpunim me Ministrinë e drejtësisë, përpiloi propozim-ligj për shërbimin prokuroror-publik të kësaj prokurorie, i cili nevojitet për ekipimin e kuadros profesionale, administrative dhe së hetuesve. Megjithatë, propozim-ligji në fjalë nuk është shqyrtuar akoma nga Qeveria, me ç'rast prokurorja speciale publike shprehi pakënaqësi për zvarritjen e procesit. Edhe se heshtja e institucioneve vazhdoi, përfundimisht më 14 dhjetor të gjithë hetuesit e kërkuar u caktuan në këtë prokurori publike, kështu që për momentin, numri i plotë i hetuesve është 13. Si pasojë e mosmarrjes së përgjigjes nga institucionet kompetente, ditën e ardhshme prokurorja speciale publike parashtrori iniciativë deri te Qeveria dhe të gjithë deputetët e Kuvendit për silljen e ligjit në fjalë në procedurë urgjente.

Të dhënat e parashtruara nga Prokurorja publike u analizuan dhe u përpilua plan për dinamikën e kërkesave të lëndëve. Fillimisht u kërkuar pesë lëndë⁴ mes cilash edhe rasti "Puç". Prokurorja publike njoftoi se përpos lëndëve

¹ Vanhoute: Partitë mundën sot të arrijnë marrëveshje për ekspertët në KSHZ. Tellma. 9.12.2015. I arritshëm në: <http://www.telma.com.mk/vesti/politichkite-partii-deneska-mozhe-da-postignat-dogovor-za-ekspertite-vo-dik>.

Orav: Prioritet i partive duhet të jetë marrëveshja për KSHZ. Tellma. 10.12.2015. I arritshëm në: <http://www.telma.com.mk/vesti/oravpriorite-na-partiite-treba-da-bide-dogovorot-za-dik>.

² Vanhoute: Zgjedhja e ekspertëve të KSHZ-së, një hap i madh para gjatë bisedimeve. MIA. 15.12.2015. I arritshëm në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/381/132945448>.

³ Neni 8 i Ligjit për prokurorinë publike për kryerjen e veprave penale që kanë të bëjnë me dhe rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve: "Prokurori publik rregullisht do ta informojë publikun për progresin e tij/saj, duke i baraspeshuar obligimet etike dhe procedurale të përcaktuara me ligj, ndërsa interesi publik duhet të jetë i informuar për rrjedhën e hetimit dhe përndjekjes".

⁴ Deri te Prokuroria themelore publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit është parashtruar kërkesë për parashtrim të lëndës së verifikuar me numër RO 90/15, ndërsa formuar pas fletëparaqitje penale nga LSDM kundër personit S.M. për vepër penale – Marrja e mitës sipas nenit 357 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 nga Kodi penal dhe vepër penale – Keqpërdorim i funksionit zyrtar dhe autorizimit nga neni 353 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 nga Kodi penal kundër S.K. për vepër penale – Marrja e mitës sipas nenit 357 paragrafi 5 lidhur me nenin 24 nga Kodi penal dhe vepër penale – Keqpërdorim i funksionit zyrtar dhe autorizimit nga neni 353 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 24 nga Kodi penal dhe X.X. për vepër penale – Dhënia e mitës sipas nenit 358 paragrafi 1 nga Kodi penal, si dhe lënda e verifikuar me numër KO 25/15 (e njohur si Puç). Deri te Prokuroria themelore publike Shkup është parashtruar kërkesë për parashtrim të lëndës verifikuar me numrin RO 770/15, formuar ndaj fletëparaqitjes së parashtruar penale nga LSDM kundër N.G., G.J., M.J. dhe kundër persona NN, të punësuar në Ministrinë e punëve të brendshme për vepër penale – Falsifikim i dokumentit sipas nenit 378 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 nga Kodi penal dhe vepër penale – Lëndim i së drejtës zgjedhore sipas nenit 159 paragrafi 2 nga Kodi penal. Deri te Prokuroria themelore publike Manastir është parashtruar kërkesë për dërgimin e lëndës së verifikuar me numër KO 636/15 kundër V.T. dhe S.B. për vepër penale – Keqpërdorim i funksionit zyrtar dhe autorizimit nga neni 353 nga Kodi penal. Deri te Prokuroria themelore publike Kumanovë është parashtruar kërkesë për dërgimin e lëndës së verifikuar me numër KO 353/15, të formuar ndaj fletëparaqitjes penale së parashtruar nga person fizik kundër personit NN – person përgjegjës për komunikime me celular dhe kundër personit juridik për vepër penale – Përgjim i paautorizuar dhe audio inçizim sipas nenit 151 paragrafi 1 dhe paragrafi 6 nga Kodi penal.

të kërkuara, u parashtruan edhe lëndë të tjera që janë formuar për vepra penale lidhur me dhe që rrjedhin nga përmbajtja e ndjekjes së pautorizuar të komunikimeve⁵.

Në pres-konferencën e mbajtur më 4 dhjetor, prokurorja Ristovska nga Prokuroria speciale publike deklaroi se do të veprojnë ndaj lëndëve për parregullsitë zgjedhore, duke u udhëhequr nga parimi se të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit⁶.

Më 14 dhjetor, Prokuroria speciale publike, duke e respektuar afatin e paraparë ligjor prej 8 ditëve⁷, solli vendimin për themelimin e kompetencës reale mbi 34 lëndë, përfshirë këtu edhe lëndën e njohur për publikun si “Puç”⁸. Në ndërkohë, sa i përket kompetencës reale mbi rastet “Monstra”, “Lagja e Trimave” dhe “Rover” do të vendoset plotësisht pas marrjes së materialeve nga komunikimet e ndjekura në mënyrë joligjore, të cilat do të dëgjohen dhe analizohen. Të njëjtën ditë, nga kryetari i partisë politike LSDM u kërkuu dorëzimi i materialeve nga komunikimet e ndjekura joligjore që i posedonte dhe për të cilat ata shprehën gatishmëri që do t’i dorëzoheshin në kërkesë të Prokurorisë së lartpërmendur.

Para **Prokurorisë themelore publike – Shkup** u formua lëndë për ngjarjen lidhur me falsifikimin e supozuar të letërnjoftimeve⁹.

Debati i gjashtë për rastin “Puç” i caktuar më 2 dhjetor u shty sepse kjo ditë ishte e deklaruar si Dita e drurit, përkatësisht ditë jopune. Njëkohësisht, u shty edhe arrestimi i Zoran Zaevit¹⁰.

Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë më 26 nëntor solli vendime për zgjedhje të kryetarit të Gjyqit të Apelit Shkup dhe kryetarë të Gjyqit Themelor Berovë dhe Gjyqit Themelor Radovish¹¹. Në seancë u miratua sistematizimi i ri i posteve gjykatëse me ç’rast u zvogëluua numri i gjykatësve të deritanishëm nga 740 në 636 gjykatës. Njëkohësisht, u sollën edhe vendime për zgjedhje të gjithsej njëmbëdhjetë gjykatësve, gjashtë prej të cilëve u zgjedhën në Gjyqin e Apelit, nga një në gjyqet e tjera të apelit dhe dy gjykatës në gjyqet themelore¹². Gjithashtu, në seancën e mbajtur më 9 dhjetor u soll vendim për zgjedhje të kryetarit të Gjyqit Themelor Strumicë dhe shpallje për zgjedhje të dy gjykatësve në Gjyqin e Lartë Administrativ¹³.

Në tryezën e rumbullakët të mbajtur më 27 nëntor, Kryetari i **Këshillit gjyqësor** deklaroi se raporti i Komisionit evropian përmban standarde të dyfishta në pjesën e gjyqësorit. Konkluzionet nga tryeza e rumbullakët janë publikuar në ueb faqen e Këshillit gjyqësor¹⁴.

Këshilli gjyqësor më 14 dhjetor solli vendim për zgjedhje të anëtarit në Këshillin për përcaktimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për konstatimin e përgjegjësisë së gjyqtarit nga rradha e profesorëve të pensionuar universitarë, përkatës i bashkësisë maqedonase të zbatohet më 28 dhjetor 2015¹⁵. Kandidat i vetëm është Prof. Dr. Simeon Gelevski nga Fakulteti i Drejtësisë “Justiniani i Parë”, Shkup.

Në lidhje me përpilimin e Strategjisë për reforma në sektorin gjyqësor¹⁶, Ministria e drejtësisë më 9 dhjetor organizoi takim konsultativ me palët e interesit, në të cilin ishin ftuar edhe përfaqësues të shoqërisë civile¹⁷. Propozim-

⁵ Njoftim për PPRM. Ueb faqja e PPRM. 04.12.2015. I arritshëm në: <http://jorm.gov.mk/?p=2368>.

⁶ Prokuroria publike fillon me procedurat parahetuese për parregullsitë zgjedhore. MIA. 4.12.2015. E arritshme në: <http://www.mia.mk/Mobile/mk/Home/RenderSingleNews/288?newsID=132929201>.

⁷ Neni 11 (3) nga Ligji për prokurorinë publike për ndjekjen e veprave penale që kanë të bëjnë me dhe që rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes joligjore të komunikimeve: “Prokurorja speciale publike vendos në afat prej tetë ditëve nëse rasti bie nën jurisdikcionin e Prokurorisë”

⁸ Numri i lëndëve që u referohen parregullsisve zgjedhore mbi të cilat kjo Prokurori publike ka themeluar kompetencë reale është 16. Mbi lëndët e Prokurorisë speciale publike Shkup Nr. RO 2362/15 dhe Nr. RO 501/15 nuk është themeluar kompetencë reale. Andaj, lëndët janë kthyer në veprim tek prokuroria kompetente themelore publike.

⁹ Njoftim: Prokuroria themelore publike – Shkup vepron ndaj lëndës për falsifikimin e supozuar të letërnjoftimeve. Ueb faqja e PTHP. 9.12.2015. I arritshëm në: <http://jorm.gov.mk/?p=2390>.

¹⁰ Nga monitoring aktivitetet e Koalicionit të Bashkësive “Të gjithë për gjykim të drejtë”.

¹¹ Njoftim nga seanca e 208-të e KGJRM-së. Ueb faqja e KGJRM-së. 26.11.2015. I arritshëm në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=366>. Për kryetar të Gjyqit të Apelit Shkup u zgjodh Liljana Ivanovska Shopova, për kryetar të Gjyqit Themelor Radovish – Kostadin Petrov dhe kryetar i Gjyqit Themelor Berovë – Emilija Buriq. Instituti për të drejtat e njeriut rregullisht e vëzhgon punën e Këshillit gjyqësor.

¹² Shpallje për zgjedhje të gjyqtarëve. 4.12.2015. E arritshme në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=369> dhe <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=371>.

¹³ Njoftim nga seanca e 209-të e KGJRM-së. Ueb faqja e KGJRM-së. 9.12.2015. I arritshëm në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=373>. Për kryetare të Gjyqit Themelor Strumicë u zgjodh Marina Abrasheva.

¹⁴ Konkluzione nga tryezat e rumbullakëta të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë. Ueb faqja e KGJRM-së. 27.11.2015. I arritshëm në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=367>.

¹⁵ Njoftim nga seanca e 210-të e KGJRM-së. Ueb faqja e KGJRM-së. 14.12.2015. I arritshëm në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=374>.

¹⁶ Propozim-strategjia është hartuar me përkrahjen profesionale dhe logjistike të projektit për përgatitje të programit për mbështetje të sektorit gjyqësor dhe të projektit IPA 2010 “Përkrahje e mëtejme për gjykatë të pavarur, përgjegjëse dhe efikase dhe promovim i gjobës së kushtëzuar dhe masave alternative”.

¹⁷ Anëtarët e Rrjetit 23 të cilët ishin aktivë në këtë fushë u ftuan në takim konsultativ. Në kuadër të takimeve vijuese, kjo strategji do të jetë detajisht e analizuar.

strategjia do të fokusohet në ndërhyrje reformuese në disa sfera: Gjykata; Sistemi juridik penal; Qasje në të drejtën dhe transparencën; Politika dhe koordinimi; Gjykata administrative; Sisteme informatike dhe e-Drejtësia. Një pjesë e mendimeve të theksuara aludojnë se Propozim-strategjia është e shkruar në stil të paqartë gjuhësor, që krijon konfuzion; parashikohen vendime që sipas thelbit të tyre kanë nevojë për ndryshime kushtetuese, si dhe ndryshime rrënjësore në ligje që sillen me shumicë dy të tretë; gjatë përgatitjes së Propozim-strategjisë nuk është konsultuar sektori civil.

Në shpalljen për trajnim fillestar në **Akademinë për gjykatës dhe prokurorë publikë** janë paraqitur 82 kandidatë për gjithsej 30 poste. Akademia do të organizojë trajnim përgatitës për të gjithë personat kanë aplikuar, me ç'rast konform ndryshimeve të reja ligjore, provimi do të realizohet përmes testimit elektronik.

Në suaza të **hulumtimit për perceptimin që avokatët e kanë për Akademinë e gjykatësve dhe prokurorëve publikë**, zbatuar nga Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë" në muajin dhjetor të vitit 2015, morrën pjesë 45 avokatë. Nga numri i plotë të të anketuarve, 67% prej tyre e kanë vlerësuar si të pamjaftueshëm kontributin e Akademisë për cilësinë e gjykatës; 76% nuk janë mjaftueshëm të njohur me punën e Akademisë; 89% prej tyre kanë konsideruar se avokatët nuk kanë qasje të mjaftueshme në trajnimet e Akademisë sepse kanë qenë shumë here të refuzuar të ndjekin trajnim; vetëm 38% kanë marrë pjesë në trajnim të organizuar nga Akademia, edhe pse 57% kanë konsideruar se ato trajnime do të jenë të dobishme; 62% kanë qenë të kënaqur nga cilësia e trajnimeve, megjithatë kanë konsideruar se më shumë avokatë duhet të angazohen si trajnues, duke i përshtatur temat dhe metodologjinë ndaj nevojave të avokatëve. Avokatët konsiderojnë se anëtarë eminentë të Odës së avokatëve duhet të bëhen anëtarë të Këshillit administrativ dhe programues të Akademisë.

Ndjekja e komunikimeve

Pas katër përpjekjeve të pasuksesshme, më 1 dhjetor **Komisioni anketues për skandalin e përgjimeve** e miratoi Rregulloren e punës¹⁸. Çështja problematike për mënyrën e sjelljes së vendimit kur ekziston barazi e votave zgjidhet në mënyrë që rast të tillë caktohet seancë e re në të cilën votohet sërish kurse rezultati i këtij votimi është përfundimtar. Është e paraparë mundësia që seanca të jetë e mbyllur për publikun në qoftë se nxjerren të dhëna të privileguara. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të parashtojë tre pyetje në 5 minuta kohë, kurse dëshmitari i ftuar ka gjithashtu kohë të njejtë në disponueshmëri të përgjigjet. Nuk është paraparë gjorbë nëse dëshmitari nuk shfaqet.

Në seancën e mbajtur më 3 dhjetor, partitë ishin të konvokuar të emërojnë nga tre persona që do të ftohen si dëshmitarë të parë¹⁹. VMRO-DPMNE kërkoi që dëshmitarët e tyre të propozuar të merren në pyetje në seancë që do të jetë e mbyllur për publikun. Kryetari Petre Shilegov përpiloi rend publik për interrogimin e dëshmitarëve, mirëpo asnjëri nga dëshmitarët e ftuar nuk u shfaq në terminin e caktuar. Kryeministri Nikolla Gruevski u prononcua në seancën e mbajtur më 14 dhjetor me dyer të mbyllura. Edhe pse dëshmitarët e ftuar nuk u shfaqën, Komisioni anketues hasi në vështirësi edhe gjatë përcaktimit të rendit ditor konform të cilit vendoset nëse dëshmitari i ftuar do të japë deklaratë.

Komisionet parlamentare për mbikëqyrjen e shërbimeve inteligjente²⁰ nuk mbajtën seancë gjatë periudhës raportuese.

Reforma zgjedhore

Komisioni parlamentar për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve më 27 nëntor e shqyrtoi listën e kandidatëve të regjistruar për anëtarë në **Komisionin Shtetëror Zgjedhor (KSHZ)**²¹. Në shpalljen e publikuar më 16 nëntor

¹⁸ Seanca nr.1 e Komisionit anketues për skandalin e përgjimeve. Ueb faqja e Kuvendit. 1.12.2015. E arritshme në: <http://www.sobranie.mk/sessiondetailsrabotni.nsp?sessionDetailsId=66516875-b315-490f-ba4e-6e9ed8ebe754&date=01.12.2015>.

¹⁹ LSDM si dëshmitarë të parë para Komisionit anketues për skandalin e përgjimeve i propozoi: Sasho Mijalkov, Mile Janakieski dhe Martin Protugjer, ndërsa VMRO-DPMNE i propozoi: Nikolla Gruevski, Zoran Stavreski dhe Gordana Jankuloska.

²⁰ Komisioni për mbikëqyrjen e punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensisë për zbulim, dhe Komisioni për mbikëqyrje të zbatimit të masës së veçantë hetuese – ndjekje të komunikimeve nga ana e Ministrisë për punë të brendshme, Drejtorisë për polici finaciare, Drejtorisë doganore dhe Ministrisë së mbrojtjes.

²¹ Përcaktimi i Listës së kandidatëve të paraqitur konform Vendimit për publikim të shpalljes për zgjedhje të kryetarit dhe anëtarëve në Komisionin shtetëror zgjedhor. Ueb faqja e Kuvendit. 27.11.2015. E arritshme në: <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=628c4b01-2c8c-4a71-90a8-ec4d70cc73f0>.

aplikuan 52 persona, prej të cilëve 12 janë kandidatë për anëtarë nga radha e partive politike, ndërsa 40 vijnë nga radha e anëtarëve të pavarur, me ç'rast tre prej tyre kanë aplikuar për të dyja bazat²².

Pas përcaktimit të listës, partitë politike në afat prej tre ditëve i parashtruan propozimet e tyre për anëtarë të KSHZ-së²³. Në afat prej tre ditëve, partitë duhej të arrinin pëlqim për emrat e anëtarëve të pavarur në grupet punuese për zbatimin e Marrëveshjes së Përzhinos. Pas kalimit të afatit të dhënë, më 15 dhjetor u arrit pëlqim që Rexhep Prekopuca, Atanas Urumov dhe Aleksandar Çiçakovski të bëhen anëtarë të pavarur të KSHZ-së²⁴. Më 16 dhjetor, Kuvendi i zgjodhi këta kandidatë për anëtarë të KSHZ-së, me ç'rast Aleksandar Çiçakovski u zgjodh kryetar, ndërsa Rexhep Prekopuca zëvendës i tij.

Depolitizimi i administratës publike

Zëvendësministri plotësues për financa nga LSDM, Kire Naumov më 27 nëntor e aplikoi të drejtën ligjore në veto dhe nuk u dakordua me huamarrjen e re të paralajmëruar të qytetarëve në vlerë prej 100 milion euro në tregun vendor²⁵. KSHZ, si kompetent për zgjedhjen e kontestit, më 30 nëntor solli vendim që emisioni i letrave shtetërore me vlerë dhe bonove shtetërore nga ana e Ministrisë së financave nuk paraqet akt ose dokument që u referohet çështjeve juridike, financiare dhe kadrovike që kanë të bëjnë me organizimin e zgjedhjeve²⁶. LSDM parashtrroi padi kundër KSHZ-së para Gjykatës administrative me arsyetim se vendimi është joligjor për shkak të jokompetencës së përbërjes aktuale të KSHZ-së, mandati i së cilës ka skaduar më 8 nëntor²⁷.

Ministri i punëve të brendshme nga LSDM-ja, Oliver Spasovski njoftoi në rrjedhë e sipër është hetimi i rrethanave për falsifikimin e letërnjoftimeve²⁸ në bazë të urdhërit nga Prokuroria publike e RM-së²⁹. Nga MPB-ja njoftuan se ekzistojnë rrethana serioze edhe për keqpërdorimin e dispozitave nga aktet nënligjore që e rregullojnë mënyrën e sigurimit dhe shfrytëzimit të automjeteve zyrtare të MPB-së³⁰. Në bazë të hetimit të kryer, u konstatua se më shumë persona kanë shfrytëzuar në mënyrë joligjore, përkatësisht kanë qenë nën mbrojtje të veçantë të sigurisë nga Ministria, duke mos plotësuar asnjë nga kriteret e përcaktuara normative³¹.

Zëvendësministri plotësues nga LSDM-ja në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave, Lupço Nikollovski njoftoi se në këtë ministri realizohen aktivitete për zbulimin e keqpërdorimeve të mundshme³².

Ministria për punë dhe politikë sociale zbatoi vëzhgim të çrregullt inspektues në të gjitha Qendrat për çështje sociale mbarë Republikës së Maqedonisë me ç'rast **ministrja për punë dhe politikë sociale nga LSDM-ja, Frosina Tashevska Remenski** njoftoi se inspektorët kanë shlytur një numër të madh mangësish gjatë funksionimit të institucioneve të përmendura³³.

²² Kostadin Babunski, Snezhana Haxhi Paunova dhe Abedin Beqiri janë tre kandidatët që janë paraqitur në të dyja listat e shpalljes – edhe si kandidatë partiakë edhe si ekspertë.

²³ Partitë propozuan kandidatë për anëtarë në KSHZ. MIA. 1.12.2015. E arritshme në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/50/132921579#>.

VMRO-DPMNE i propozoi: Sillvana Boneva dhe Sasho Sërcev; LSDM – Violeta Duma dhe Igor Milev; BDI – Hisni Jakupi dhe PDSH - Bedredin Ibraimi.

²⁴ Marrëveshje e arritur për përbërjen e plotë të KSHZ-së. MIA. 15.12.2015. E arritshme në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/380/132945461>.

²⁵ LSDM nuk dakordohet me huamarrjen e re prej 100 milion euro. Ueb faqja e LSDM-së. 27.11.2015. E arritshme në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=2&articleId=12925>.

²⁶ KSHZ dha pëlqim për huamarrjen. Agjensioni gazetaresk META. 30.11.2015. E arritshme në: <http://meta.mk/dik-dade-zelено-svetlo-zadolzhuvaneto/>.

²⁷ Padi deri te Gjykata administrative kundër vendimit joligjor për përbërjen paraprake të KSHZ-së. Ueb faqja e LSDM-së. 15.12.2015. E arritshme në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=13162>.

²⁸ Gazetari Lubisha Arsiq nga javorja "Fokus" publikoi tekst ku pohon se gjatë zgjedhjeve të fundit në dy lokacione në lagjen Shuto Orizari dhe në qytetin Shtip janë krijuar mbi dhjetë mijë letërnjoftime false. 30. 000 letërnjoftime false për fitore në zgjedhje. Fokus. 20.11.2015. E arritshme në: <http://fokus.mk/fokus-express/30-000-lazhni-lichni-karti-za-pobeda-na-izbori/>.

²⁹ Spasovski: Në rrjedhë e sipër është hetimi për rrethanat e letërnjoftimeve false. MIA. 30.1.2015. E arritshme në: <http://www.mia.mk/mk/Inside/RenderSingleNews/50/132919932>.

³⁰ Ministri Spasovski mbajti pres konferencë dhe brifing me gazetarët. Ueb faqja e MPB-së. 7.12.2015. E arritshme në: <http://www.mvr.gov.mk/vest/1009>.

³¹ Njoftim për publikun. Ueb faqja e MPB-së. 10.12.2015. E arritshme në: <http://www.mvr.gov.mk/vest/1034>.

³² Fillojmë me zbulimin e keqpërdorimeve. Ueb faqja e LSDM-së. 4.12.2015. E arritshme në: <http://www.sds.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=5&articleId=13031>.

Ministri për bujqësi, pylltari dhe ekonomizim të ujërave, Mihaill Cvetkov si dhe zëvendësministri plotësues i ministrisë së njejtë më 13 dhjetor morrën pjesë në debat në Tv Alsat – M: <http://alsat-m.tv/episode/226246/subvencionet-per-lasin-ministrin-dhe-zv-ministrin-e-bujqesise>.

³³ Vëzhgim i çrregullt inspektues në Qendrat për çështje sociale. Ueb faqja e MPPS-së. 9.12.2015. I arritshëm në: http://www.mtsp.gov.mk/pocetna-nas_article-vonreden-inspekcijski-nadzor-vo-centrite-za-socjalni-raboti.nsp.x.

Zëvendësministri plotësues për shoqëri informatike dhe administratë nga LSDM-ja, Aleksandar Kiracovski kërkoi që dispozitat nga Ligji për nëpunësit administrativë sa i përket vlerësimit të vendosen në “pushim”³⁴. Sipas tij, “nevojiten vendime cilësore që do t’a nxisin administratën të punojë, e jo dispozita për presion dhe keqpërdorime synuar në qëllime politike”. Ndaj kësaj deklarate, u shpreh reagim nga **Ministria për shoqëri informatike dhe administratë (MSHIA)**. Në njoftimin e shpallur në ueb faqen e MSHIA-së, theksohet se cikli i “vlerësimit” për vitin 2015 duhej të fillojë që në dhjetor të 2014-tës. Megjithatë, gjatë asaj periudhe kohore Ligji për nëpunësit administrativë ende nuk kishte hyrë në fuqi, andaj “vlerësimi” për vitin 2015 paraqet një pilot-vlerësim me të cilin nuk do të shqiptohen masa për performancë të shkëlqyer dhe të dobët³⁵.

Media

Nuk ka progres në negociatat për reforma në mediat dhe të gjitha afatet për arritjen e marrëveshjes kanë kaluar³⁶. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Sindikati i pavarur i gazetarëve të Maqedonisë (SPGM) dhe Instituti maqedonas për mediat (IMM) të shqetësuar që partitë politike dakordohen me dyer të mbyllura dhe pa pranishmëri të gazetarëve dhe të punësuarve në media, organizuan një demonstratë më 25 nëntor para Klubit të deputetëve³⁷. Përfaqësuesit e grupit punues nga LSDM shprehën përkrahje për kërkesat e tilla, duke njoftuar se propozimin për përfshirjen e mediave dhe organizatave gazetareske do t’a vënë në pronocim nga pjesëmarrësit tjerë gjatë negociatave³⁸.

Lehtësuesi Vanhoute më 30 nëntor e prezantoi propozim-ligjin për mediat. Ky propozim-ligj parashikon që anëtarët e Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale (ASHMAAV) të jenë profesionistë dhe ekspertë të cilët duhet të sigurojnë edhe mbështetje nga sfera e tyre dhe nga organizata të tjera që u përkushtohen mediave, ndërkaq zgjedhen me shumicën e dy të tretave në Kuvendin e RM-së në bazë të konkursit publik. Anëtarët e zgjedhur do të kenë mandat prej pesë viteve me mundësi për ri-zgjedhje. Drejtori i ASHMAAV-së do të emërohet nga ana e Këshillit dhe do të ketë kompetenca të zvogëluara. Në rast të shkeljes së rregullave nga ana e cilit do medium, Këshilli do të nisë dialog me mediumin, me ç’rast masa e parë do të jetë paralajmëtim, ndërsa liçenca do të merret në rast të shkeljeve të rrepta. Ngjashëm do të zgjedhen edhe anëtarët e Këshillit programues të RTVM-së. Sa i përket financimit të shërbimit publik, propozohet abrogim i taksës radiodifuzive dhe finacim nga shteti në shumë prej 1% nga buxheti.

Më 1 dhjetor, VMRO-DPMNE i braktisi negociatat dhe në njoftimin e vetë potencoi: “Nuk do të lejojmë që qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët e gëzojnë lirinë e informimit, si dhe mediat në vend që e gëzojnë lirinë e të shprehurit të bëhen viktima të ideologjisë totalitare të LSDM-së dhe ligjeve fashistike që ata dëshirojnë t’i fusin në Maqedoni”³⁹. Partia u kthye në tryezën e negociatave më 3 dhjetor dhe kërkoi nga shoqatat gazetareske dhe mediale, si dhe nga organizatat tjera joqeveritare t’i parashtrijnë propozimet e tyre për reforma në sferën e mediave. Propozime parashtruan SHGM dhe IMM. Siç njoftohet, negociatat vazhdojnë më 16 dhjetor, pas përfundimit të takimit të liderëve në të cilin u dakordua për përbërjen e KSHZ-së.

Gjyqi Themelor Shkup 2 Shkup gjatë gjykimit të përsëritur ndaj padisë për shpifje dhe ofendim⁴⁰ të parashtruar nga ministrja e mëparshme e punëve të brendshme, Gordana Jankulovska kundër Petre Shilegov nga LSDM, solli vendim sipas së cilit Shilegov duhet t’i paguajë Jankulovskës dëmshpërblim në lartësi prej 200 mijë denarë⁴¹. Paraprakisht, Gjyqi i Apelit e anuloi vendimin e instancës së parë për pagesë të dëmshpërblimit prej 500 mijë denarëve.

³⁴ Kërkoj që Gruevski menjëherë të ndërprejë me gjobat për administratën. Ueb faqja e LSDM-së. 16.12.2015. E arritshme në: <http://sdsm.org.mk/default.aspx?articleId=13173&mld=55&agld=6>.

³⁵ Reagimi i MSHIA-së. Ueb faqja e MSHIA-së. 16.12.2015. E arritshme në: <http://www.mio.gov.mk/?q=node/4100>.

³⁶ Nga aktivitetet e monitorimit të Fondacionit OJQ Info qendër.

³⁷ Publiku duhet t’a dijë për ç’farë dakordohen partitë për mediat. SHGM. 26.11.2015. E arritshme në: <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/930>.

³⁸ Kërkojmë që mediat dhe organizatat joqeveritare të bëhen pjesë e procesit të negociatave. Ueb faqja e LSDM-së. 30.11.2015. E arritshme në: <http://www.sdsm.org.mk/default.aspx?mld=55&agld=5&articleId=12960>.

³⁹ Zaevi dhe LSDM-ja sot shfaqën mburrje të paparë, destruktivitet dhe mungesë të kapacitetit themelor demokratik dhe pluralistik. VMRO-DPMNE. 1.12.2015. E arritshme në: <http://vmro-dpmne.org.mk/?p=28486>.

⁴⁰ Jankulovska e parashtroi padinë për shpifje dhe ofendim kundër Shilegovit në shtator të 2014-tës për shkak të nxjerrjes së informatave të pavërteta në publik me të cilat pohon se pasi që ka hyrë në funksionin e ministrit në MPB, prona e saj është zmadhuar në 200 mijë euro vetëm me apartamente.

⁴¹ Nga aktivitetet e monitorimit të Fondacionit OJQ Info qendër.